

SHEJZAT

pleiades ★ 2019 ★ 1-2

Janar-Qershor 2019

January-June 2019

P È R M B A J T J A

Content

	Page
HISTORICA	
José M. Floristán <i>Stradloti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna (I).</i> <i>Le famiglie albanesi Buq, Crescia e Renesi</i>	3
Arben Ndreca <i>Disa dokumente rreth Gjon dhe Gjergj Kastriotit në sllavishten e vjetër</i> <i>(Pjesa II).</i>	47
Italo Sarro <i>Le missioni sopra Scutari al tempo di Mons. G. Radovani</i>	70
Bardhyl Demiraj <i>Enigma filologjike në Gravurën e Ardenicës.</i>	101
Carlo Parodi Summa <i>La figura di Ernesto Cozzi. Da missionario in Albania</i> <i>a Delegato Apostolico</i>	129

HUMANIORA

Matteo Mandalà

Sulla traduzione della letteratura orale arbëreshe e la polemica dimenticata tra Schirò e De Grazia 159

Giuseppina Turano

Përkthimi ndërgjuhësor dhe ai ndërkulturor. Problemi i marrëdhënies me alteritetin: rasti i romanit Prilli i thyer i Ismail Kadarese 170

Emine Sadiku

Konsumimi semantik, burim i pashtrshëm shprehësie 183

Mimoza Hysa

"Korbi" i Isuf Luzajç – si model i poezisë së tij filozofike 206

ARCHIVUM

Karl Gurakuqi

Testamenti i Mustafja Krujës 213

Zef Valentini

Mustafja Kruja mjeshër gjuhe 217

Ernest Koliqi

Mustafja Kruja si njëri kulture 223

RECENSIONE

Evalda Paci

Lucia Nadin, Ikona e Shëndërbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut. Nga historia te miti: shëkujt XV-XVIII, Tiranë 2018 231

José M. FLORISTÁN

Stradioti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna (!): le famiglie albanesi Bua, Crescia e Renesi*

Albanian Stradiots at the service of the Spanish Habsburgs

Abstract: *The purpose of this paper, the first in a series, is to provide the Albanologists with historical data concerning the lives and deeds of offspring from prominent Albanian families at the service of the Spanish Habsburgs during the 16th and 17th centuries. Residing at General Archives of Simancas (Valladolid, Spain), most of the authentic documents displayed and discussed on in the following essay have been unknown until now. This is the first study strictly devoted to several members of the Albanian families Bua, Crescia and Renesi.*

Keywords: *Albanian families Bua, Crescia, Renesi; Spanish Habsburgs; 16th and 17th centuries; Naples; Stradiots.*

L'emigrazione albanese in età moderna ebbe due destinazioni principali: Venezia e i suoi territori di terraferma nel nord e Napoli e la Sicilia nel sud¹. Gli albanesi si insediarono anche a Ragusa (Dubrovnik) e in altre città della Dalmazia, però in numero minore e temporaneamente. Nel caso di Venezia, furono le intense relazioni politiche e commerciali che la Serenissima aveva mantenuto con l'Albania attraverso l'Albania veneta (Budua, Dulcigno, Antivari, Cattaro, Scutari e Durazzo) nel medioevo, che spinsero gli Albanesi, provenienti maggiormente dal nord e dal centro dell'Albania, ad insediarsi². Gli albanesi del sud, invece, i quali dalla metà del XIV secolo si erano riversati per l'Epiro del sud e avevano attraversato il Peloponneso, preferirono emigrare nelle isole Ioniche sotto la sovranità veneziana, in particolare a Corfù, e nei regni di Napoli e di Sicilia, sotto

* Le abbreviazioni usate: ACS: Archivo General de Simancas (Valladolid, España); AHN: Archivo Histórico Nacional (Madrid); SP80: Secretarías provinciales, legajo 80; SP lib. 503: idem, libro 503; E: Estado; E1578: Estado, legajo 1578; f(s): folio(s); s. f.: senza nr. di f. Desidero ringraziare la mia studentessa Elvira Rodríguez dell'elaborazione degli alberti genealogici che accompagnano questo studio.

1 Nella vasta bibliografia sull'emigrazione albanese in Italia si può consultare Ducejlier 1967, Barti 1979, Giura 1984, Anselmi (ed.) 1988, Rotelli (ed.) 1990, Nadin 2008 ed anche Esposito 2017.

2 Ducejlier 1967: 420

Përkthimi ndërgjuhësor dhe ai ndërkulturor.
 Problemi i marrëdhënies me aleritetin:
 rasti i romanit *Prilli i thyer* i Ismail Kadarese

Interlingual and intercultural translation. The relationship with alerity: the case of Ismail Kadare's novel *Broken April*

Abstract: *In her paper, author Turano focuses on issues relating with the translation of Ismail Kadare's novel *Broken April* from Albanian into French and Italian. In fact, she analyses the different solutions adopted by Italian and French translators in order to render specific words and expressions mirroring special values in Albanian culture; words and expressions that refer to customs and traditions which can be easily understood in Albanian but can seem obscure to the average Italian or French readers. Despite the complexity of the problems encountered during the translation process, due to the natural limitations imposed by the foreign linguistic and cultural context, the translators succeeded in recreating the atmosphere of the original novel in Albanian, without missing out on the quintessence of this literary work. The Italian and French translations alike evoke the same emotional response and the same feelings as the original novel, witnessing that the translation of any literary work can potentially allow us to overcome language barriers, even though this raises additional theoretical and practical problems.*

Keywords: *Albanian, translation, expressions, Ismail Kadare, language, culture, Broken April.*

1. Hyrje

Në këtë shkrim do të ndalemi në disa çështje që lidhen me përkthimin në gjuhën frënge dhe italiane të romanit *Prilli i thyer* të Ismail Kadarese. Vepra u përkthye në italisht nga Flavia Celotto dhe u botua nga Longanesi (Milano) në vitin 2008 me titullin *Aprile spezzato*. Si tekst bazë, përkthyesja ka përdorur variantin në frëngjisht *Avril Brisé*, botuar nga Fayard në vitin 1982 me përkthimin e Jusuf Vrionit. Përkthimi italian (Longanesi 2008) ndjek me besnikëri variantin francez (Fayard 1982).

I shkruar në vitin 1978, *Prilli i thyer* u botua fillimisht në Tiranë më 1980 në përmbledhjen *Gjakfshëtesia*, kurse si libër më vete doli në vitin 2003 nga shtëpia botuese Onufri (Tiranë). Është një roman i veçantë për

një sërë arsyesh. Është i vetmi roman në të cilin trajtohet gjerësisht tema e gjakmarrjes; është i vetmi në të cilin përshkruhet me hollësi mekanizmi i Kanunit, kodi zakonor shqiptar, dhe ndikimi i tij në jetën e malësorëve, në krahinën e Mirditës. Gjakmarrja, pajtimi, fisi, vëllazëria; vlera morale si nderi, besa e vogël, besa e madhe, miqpritja dhe të gjitha nënë më të shpikatura të kanunit si dhe doket, zakonet, traditat, ritualet, ligji sipas të cilit jetonin njerëzit e maleve, çdo gjë është përshkruar deri në hollësi të më të imëta.

Në këtë roman kryqëzohen dy linja: linja e personazhit kryesor, malësorit Gjorg Berisha, i shtrënguar nga prindërit dhe të afërmit, kundër vullnetit e tij, të bëhet vrasës për të marrë gjakun e të vëllait; linja e çiftit Besian dhe Diana Vorpsi që kanë marrë rrugën për në malësi të Veriut, për muaj mjaliti. Këto dy linja përpuqen kur shtegtimi i çiftit kryqëzohet me atë të Gjorgut dhe kur sytë e Gjorgut kryqëzohen me ato të Dianës: një shikim fatal që do ta çojë Gjorgun drejt vdekjes.

Prilli i thyer është një tekst që ngërthen në vetvete një identitet gjuhësor dhe kulturor të vështirë për t'u përkthyer për shkak se terminologjia e përdorur aty jo gjithnjë e gjen korrespondentin e vet të drejtpërdrejtë në një gjuhë tjetër, siç e dëshmojnë variantet e përkthimit në gjuhën franceze dhe atë italiane.

Duke krahasuar romanin original me këto përkthime, do të marrim në analizë zgjidhjet e ndryshme të zbatuara nga përkthyesit Jusuf Vrioni dhe Flavia Celotto përkatësisht në frëngjisht dhe italisht. Konkretisht, do të hidhet dritë mbi mënyrat e përdorura për përkthimin e atyre fjalëve dhe shprehjeve që mbartin vlera specifike të kulturës shqiptare, lidhur me botën e Kanunit dhe me një realitet social-kulturor të caktuar, si ai i Malësisë. Vështrësia më e madhe lidhet me gjeçjen e barasvlerësve në gjuhën frënge dhe italiane të disa fjalëve shqipe që lidhen me etno-kulturën e popullit shqiptar.

Nga përqasja e origjinalit shqip (Onufri 2003) me botimin francez dhe atë italian, kanë dalë në pah strategji të ndryshme përkthimi:

- a) terma që nuk janë përkthyer as nga Vrioni, as nga Celotto, të cilët i kanë lënë në gjuhën shqipe dhe i kanë shpjeguar në fushnotë;
- b) terma që nuk janë përkthyer, por mbeten në gjuhën shqipe dhe janë të shpjguara në tekst;
- c) terma që mbeten në gjuhën shqipe pa asnjë shpjegim;
- d) fjalë, shprehje ose fjali të përkthyer me një kuptim që nuk përputhet plotësisht me origjinalin shqip.

Më poshtë do të marrim në analizë secilën prej këtyre strategjive, duke u mbështetur në shembuj konkretë nga të tre botimet.

2. Fjalë të shpjguara në fushotë

Për sa i takon strategjisë së parë, përkthyesit kanë lënë në gjithën shqipe fjalët "kanun", "kullë", "besë", "gjakës", "gjalkhupës" dhe "trafsh". Këto fjalë i kanë sqaruar në fushotë me anë të perfrfazimit. Megjensë janë terma që u referohen elementeve ose dukurive të panjohura për lexuesin e huaj, sepse lidhen me zakone dhe doke të popullit shqiptar, shpeshherë shpjegimi në fushotë nuk tregon plotësisht rëndësinë e këtyre nocioneve. Kështu, për shembull, fjala "Kanun" (që është shkruar sipas grafitë shqipe si në frëngjisht ashtu edhe në italisht) parafrazohet si *Code*, *recueil de règles de droit coutumier* (ed. fr. f. 11)¹/*Codice, raccolta di norme di diritto consuetudinario* (ed. it. f. 10) 'Kod, mbledhje e rregullave të së drejtës zakonore'. Ky shënim, sado i përtafërt, ka mangësi të ndjeshme sepse nuk e rrok gjithë atë gamë çështesh që trajtohen në Kanun, ku nënet dhe artikujt e tij parashikojnë dhe rregullojnë çdo aspekt të jetës shoqërore shqiptare, e në veçanti të malësorëve. Kështu që ta përkufizosh atë thjesht dhe vetëm si një përmblendje e të zakonave dhe të traditave të malësorëve është një e vërtetë e pjeshme, pasi kanuni mbetet një vepër monumentale e cila ngërthen në vetvetë cilësitë themelore të shpirtit të shqiptarit, si nderi, besa, burrëria, mikpritja, etj.

Fjala e dytë është "kullë". Ajo parafrazohet si *Demeure de pierre en forme de tour, propre aux montagnes albanaises* (ed. fr. f. 11)/*Dimora in pietra a forma di torre, tipica delle montagne albanesi* (ed. it. f. 10) 'Shtëpi guri në formën e kullës, tipike për malet shqiptare'. Ky shpjegim nuk jep një pamje të plotë për llojin e kësaj banese, pasi nuk merr në konsideratë ato detaje, për të cilat shquhet në mënyrë të veçantë një ndërtesë e tillë, si frëngjishtë për pushkë në vend të dritareve; kati përdehe i pabanuar; që përdoret si vahë për bagëtitë; hapësirat në pjesën e sipërme. Në shpjegimin që ofrojnë përkthyesit nuk gjendet asnjë e dhënë rreth këtyre tipareve thelbësore që e dallojnë një banesë të zakonshme nga një kullë. Për këtë të fundit nuk gjendet një fjalë barasvlerëse as në frëngjisht dhe as në italisht.

Një dukuri tjetër, lidhur me fjalën "kullë", është mënyra se si na e sjellin të shkruar përkthyesit. Si në botimin francez, ashtu edhe në atë italian, fjala është shkruar sipas grafitë origjinale, *kulla*, por, termi, që në shqip është në trajtën e shquar; trajtohet si i pashquar. Pra, në përkthim del gjithnjë i shoqëruar me nryen e shquar ose të pashquar *la/une kulla* (ed. fr. f. 12, 28)/*la/una kulla* (ed. it. f. 10, 21). Përveç kësaj, në përkthimin francez është përdorur sistemi i morfologjisë së gjuhës franceze, kështu që kur fjala është në numrin shumës merr mbaresën -s *les kullas* (f. 19); kurse në botimin italian vetëm nrya e bën dallimin midis njëjësit dhe shumës *la/le kulla* (f. 36, 52).

¹ 'Ed. fr: përdoret si shkurtësë për të treguar botimin francez; 'ed. it: përdoret për botimin italian; 'ed. shq: për botimin shqip.

Përsa i përket fjalës "besa" (që, në përkthimin francez, është shkruar *bessa*), në shënimin e vënë në fushotë, tek botimi francez jepet ky shpjegim *Notion fondamentale du code moral de l'Albanais. Foi, protection/jurée, respect de la parole donnée* (f. 14) 'Koncept themelor i kodit moral të shqiptarit. Besnikëri; mbrojtje e betuar, respekt për fjalën e dhënë'. Në botimin italian (ku del e shkruar sipas grafitë origjinale *bessa*), përkthimi ndryshon pak: *Nozione fondamentale nel codice morale albanese: lealtà, impegno a non attaccare, rispetto della parola data* (f. 12) 'Koncept themelor në kodin moral shqiptar: besnikëri, zotim për të mos sulmuar, respekt për fjalën e dhënë'.

"Besa" është një ndër institucionet më të rëndësishme të Kanunit dhe mbart kuptime të ndryshme. Në Kanun, "besa" është formuluar në mënyra të ndryshme. Së pari, është fjala e dhënë, dhe si e tillë ajo përbën thelbin e të drejtës zakonore shqiptare, sepse të gjitha marrëdhëniet e njeriut me familjen, me fisin, me flamurin mbaheshin në fjalë. "Besa" është lidhje në fjalë, prandaj çka premtohet, medoemos duhet kryer. Së dyti, ajo siguronte papërkshëmërinë e një marrëveshjeje. Për shembull, në Librin X të Kanunit bëhet fjalë për besën midis flamurëve, që u siguron mbrojtje udhëtarëve. Së treti, "besa" është armëpushim (Libri X): një periudhë lirie e sigurimi që shtëpia e të vrarit i jep dorasit dhe familjes së tij, falë premtimit që s' do ta ndjekë për gjak për një periudhë të caktuar. Në romanin *Prilli i thyer*, fjala "besë" del me të tre këto kuptime: "fjalë e dhënë", "mbrojtje" dhe "armëpushim". Nga shpjegimi i përkthyesve në fushotë, këto kuptime nuk dalin të plota, ndaj dhe mesazhi tek lexuesi mbërrin i mangët. Ajo përdoret shumë herë si 'fjalë e dhënë', siç e dëshmojnë këto shembuj: [...] *la trahison de l'hôte lié par la besa* (ed. fr. p. 47)/*il tradimento dell'ospite protetto dalla besa* (ed. it. p. 35) 'Prejta e mikut në besë'; [...] *une violation de la besa* (ed. fr. p. 47)/*una violazione della besa* (ed. it. p. 35) 'një prejje në besë'; [...] *d'un village lointain qui avait violé la besa* [...] (ed. fr. p. 48)/[...] *di un villaggio lontano che aveva violato la besa* [...] (ed. it. p. 35) 'i një katundi të largët besëshkelës'; [...] *s'était lié à lui par la besa* (ed. fr. p. 87)/*si era legato a lui con la besa* (ed. it. p. 64) 'u pre mik në besë të tij'.

Në fjalë të tjera, fjala "besë" mbart kuptimin e "mbrojtjes": Ja disa shembuj: [...] *Je serai tué sous sa besa* (ed. fr. p. 87)/[...] *sono stato ucciso sotto la sua besa* (ed. it. p. 63) 'u vrava nën besë të tij'; *Des troncans particuliers en étaient garantis par la besa perpétuelle* [...] (ed. fr. p. 167)/*Particolari tratti erano garantiti dalla besa perpetua* (ed. it. p. 120) 'Copa të veçanta (të këtyre rrugëve) ishin në besë të përhershme'; [...] *les autres lieux protégés par une besa particulière* [...] (ed. fr. p. 167)/[...] *gli altri luoghi protetti da una particolare besa* [...] (ed. it. p. 120) 'vendet e tjera që ishin në besë të veçantë'; [...] *la route ou l'auberge places sous la protection de la besa* [...] (ed. fr. p. 168)/[...] *la strada o la locanda sottoposte alla besa* (ed. it. p. 121)

'rruga ose bujtina në besë'; *Je crois que c'est une route protégée par la bessa* (ed. fr. p. 189) / *Crede che sia una strada protetta dalla bessa* (ed. it. p. 136) 'besoj se kjo është një rrugë në besë'; [...] *la route, croyait-il, jouissait de la bessa* (ed. fr. p. 236) / [...] *la strada, così pensava, godeva della bessa* (ed. it. p. 168) 'rruga, kështu i dukej, ishte në besë'.

Por, në më të shumtën e rasteve fjalat përdoret me kuptimin "armëpushim":
Ja disa shembuj: *Les médiateurs vont solliciter la bessa* [...] (ed. fr. p. 14) / *I mediatori vanno a sollecitare la bessa* (ed. it. p. 12) 'dërmjetësit po shkojnë të kërkojnë besën'; *La famille des Kryeqyqe a accordé la bessa!* (ed. fr. p. 15) / *La famiglia dei Kryeqyqe ha concesso la bessa!* (ed. it. p. 12) 'Familja e Kryeqyqëve e dha besën'; [...] *afin de solliciter pour lui la grande bessa de trente jours* (ed. fr. p. 19) / [...] *al fine di sollecitare per lui la grande bessa di trenta giorni* (ed. it. p. 15) 'për të kërkuar për të besën e madhe, tridhjetëditëshen'; [...] *sa bessa expirait ce jour* (ed. fr. p. 229) / [...] *la sua bessa scadeva quel giorno* (ed. it. p. 163) 'besa e tij mbaronte atë ditë'; [...] *si le bénéficiaire de la bessa était tué précisément le jour de son expiration* [...] (ed. fr. p. 230) / [...] *se il beneficiario della bessa fosse stato ucciso il giorno stesso della scadenza* [...] (ed. it. p. 163) 'në qoftë se besëtuari vritej pikërisht ditën e mbarimit të besës'; *Encore un peu et sa bessa expirerait* [...] (ed. fr. p. 233) / *Fra poco la sua bessa sarebbe scaduta* [...] (ed. it. p. 166) 'Edhe pak dhe koha e besës merrte fund'; *Sa bessa avait expiré* (ed. fr. p. 235) / *La sua bessa era scaduta* (ed. it. p. 167) 'Koha e besës kishte mbaruar'; *C'était donc cela, le temps au-delà de la bessa?* (ed. fr. p. 236) / *Era dunque, questo, il tempo al di là della bessa?* (ed. it. p. 168) 'kjo ishte koha përtej besës?'; *Ta bessa a expiré?* (ed. fr. p. 239) / *La tua bessa è scaduta?* (ed. it. p. 170) 'të ka mbaruar besa?'.
Kalimi nga një kuptim tek tjetri nuk del i shpjeguar qartë: vetëm konteksti ndihmon. Asnjë shpjegim nuk jepet për të kuptuar ndryshimin midis besës së vogël, njëzetekatërorëshe, e cila kërkohet nga ndërmjetësit dhe e detyron vrasësin të marrë pjesë si në varrimin e viktimitës, ashtu edhe në drekën e mortit dhe besës së madhe, tridhjetëditëshe, e cila kërkohet nga pleqtë e fshtatit, në mënyrë që të afërmit e të vrarit t'i garantojnë vrasësit armëpushim për një muaj.
Një term tjetër i shpjeguar në fushnotë është "gjakës", që në botimin francez del në variantin *giakës*, dhe është i parafrazuar si *De l'albanais giak: sangj, meurtrier, mais sans la connotation péjorative qui s'attache à ce terme, le giak accomplissant son devoir aux termes du Kanun ou Coutumier* (f. 16) 'Nga shqipja *giak*: vrasës, por pa kuptimin negativ të nënkuptuar nga ky term, *giakësi* duke përmbyshur detyrën e tij sipas Kanunit'. Në botimin italian, del e shkruar *giakës* dhe parafrazohet si *Dall'albanese giak (sangue). «Assassin», dunque, ma senza la connotazione peggiorativa implicita in questo termine, poiché il giakës compie il suo dovere a norma del Kanun* (f. 13) 'Nga shqipja *giak*. «Vrasës», pra, por pa kuptimin negativ të nënkuptuar

në këtë term, pasi *giakësi* përmbysh detyrën e tij sipas Kanunit'. Me anë të një shpjegimi kaq të shkurtër, përkthyesit mëtojnë të kapërcejnë një terren shumë të vështirë. Sipas Kanunit, vrasja nuk shikohet si krim: gjakmarrja kryhet në emër të nderit; është një detyrim moral i përbashkët për familjen dhe fisin. Por, lexuesit që nuk i njeh nenet e Kanunit, nuk ia rrok mendja se kryerja e gjakmarrjes kthehet në virtyt. Kush merr gjakun e humbur i kthen nderin familjes dhe tregohet burrë. Lexuesi që nuk e njeh mekanizmin e Kanunit, dhe mënyrat se si vepron ai, nuk e ka të qartë se pse një *giakës* nuk konsiderohet vrasës; nuk e di se në Kanun vrasja s'është veçse detyrë që duhet përmbyshur, ndërsa mosrespektimi i saj është turp e faqe e zeze. Fatkeqësisht, nga shënimet në fushnotë, këto detaje sa të imëta po aq të rëndësishme, nuk jepen qartë.

Krahas fjalës "gjakës" del dhe fjala "gjakhupës", e shkruar sipas grafisë origjinale. Në roman, u referohet si viteve në të cilët gjaku nuk rridhte, ashtu edhe njëzëve që Kanuni konsideronte gjakhupës. E para është e shpjeguar në fushnotë si: *De l'albanais giak: sang et hup: perdre; c'est-à-dire où le sang se perdait, où l'on était pas tenu à reprendre le sang* (ed. fr. p. 156) 'Nga shqipja *giak* dhe *humb*; domethënë, kur gjaku ishte i humbur, kur nuk kishte detyrim të shpërblehej gjaku'. Disi ndryshe në botimin italian: *Dall'albanese giak (sangue) e hup («perdere»)*. *Vale a dire anni in cui il sangue si perdeva, non essendoci l'obbligo di riscattarlo* (ed. it. f. 113) 'Nga shqipja «gjak» dhe «humb». Domethënë, vite në të cilët gjaku ishte i humbur, pasi nuk kishte farë detyrimi për ta shpërbyer'. Në roman bëhet fjalë për gjakun e derdhur nga shqiptarët në luftë me të huajt gjatë kryengritjeve të viteve 1878, 1879 dhe 1880, kur gjakmarrja pushonte së geni. Gjaku i derdhur nuk lidhej me gjakmarrjet mes familjeve ose fiseve, pra ishte gjak i humbur sepse derdhej për arsye jashtë botëkuptimit kanunor.

Listën e termave të shpjeguara në fushnotë e mbyll fjala "rrafsh". Ajo parafrazohet si: *Rrafsh: en albanais, plateau* (ed. fr. f. 43) '*Rrafsh*: në shqip, rrafsh' / *«Altipiano» in albanese* (ed. it. f. 32) '«Rrafsh» në gjuhën shqipe'. Edhe pse gjeografja franceze *plateau* dhe ajo italiane *altipiano* i përshatën fjalës shqipe "rrafsh", shpesh, në të dy përkthimet e gjejmë këtë fjalë të jenë në shqip dhe me shkronjë të madhe. Në fakt, vetë Kadare, në roman, e shkruan fjalën me shkronjë të madhe si për të treguar jo vetëm një zonë gjeografike por, mbi të gjitha, përkatësinë etnike.

Ndryshe nga botimi francez, në përkthimin italian mungon shpjegimi i fjalës "lahutë" që Vriani e vë në fushnotë. Në përkthimin frëngjisht del e shkruar sipas shqiptimit të kësaj gjuhe *lahoute* dhe parafrazohet si: *Instrument à long manche et à corde unique* (f. 169) 'Vegël me bisht të gjatë dhe me një tel të vetëm'. Në botimin italian, fjala është lenë në shqip (f. 121, 144) pa ndonjë shpjegim në fushnotë apo në tekst që mund të shqarojë kuptimin e saj.

Siç mund të vërehet, brënda kësaj strategjie përfshihen, nga njëra anë, fjalë të tekstit të Kanunit ("besë", "gjakës", "gjakhupës") pra, fjalë që shënojnë koncepte të një fushe të caktuar; nga ana tjetër, fjalë si "kullë", 'lahutë', etj., që ekzistojnë në gjuhën burimore por jo në gjuhën e përkthimit dhe lidhen me kontekstin kulturor dhe shoqëror shqiptar. Në shumicën e rasteve, fujqia shprehëse që kanë këto fjalë në gjuhën shqipe nuk del e plotë as në gjuhën franceze, as në atë italiane.

3. Fjalë të shpjeguara në tekst

Përgjatë romanit *Prilli i thyer*, gjejmë tri fjalë, "krushq", "krushkapar" dhe "gjakhupes" që, në përkthimin frëngjisht dhe italisht, janë lënë në shqip, por janë të shoqëruara me një shpjegim brenda tekstit. Tema të tillë shënojnë koncepte që i referohen një hapësire kulturore krejt të panjohur si për lexuesin francez, ashtu dhe për atë italian. Këtyre fjalëve nuk u gjendet një referent i drejtpërdrejtë në gjuhën e mbërtitjes. Pikerisht këtu qëndron vështirësia e përkthimit të tyre.

Për fjalën "krushq" që, në përkthimin frangjisht, është e shkruar sipas shqiptimit në gjuhën franceze *krouchks*, shpjegimi që jep përkthyesi është: *des proches de la famille qui la conduisaient [la mariée] chez son époux* (ed. fr. f. 30) 'të afërm të familjes që e sjellin [nusen] në shtëpinë e dhëndërit'. Gjatë përkthimit, janë ndjekur dy strategji: ose është lënë shqip por me grafinë *krouchks*, ose është e përkthyer jo si një herë, herën tjetër. Prandaj e gjejmë të përkthyer si *cortège nuptial* (ed. fr. f. 30) 'vargan dasme', si *les proches de la mariée* (ed. fr. f. 31) 'të afërmit e nuses', *les paronymes* (ed. fr. f. 31) 'shkuesit'. Përkthyesja italiane, që e ka lënë fjalën me grafinë shqipe *krushq*, në ndryshim nga botimi francez, ka shtuar në tekst shpjegimin: *i parenti della donna che veniva condotta alla dimora del suo sposo* (ed. it. f. 23) 'të afërmit e gruas që përcillej në shtëpinë e dhëndërit'. Por, duke ndjekur me besnikëri botimin francez, më poshtë, fjalën e përkthën si *corteo nuziale* (ed. it. f. 23) 'vargan dasme', *i parenti della sposa* (ed. it. f. 23) 'të afërmit e nuses', *i paronimi* (ed. it. f. 24) 'shkuesit'. Përkthimi i një koncepti si ai i fjalës "krushq" me anë të shprehjeve të ndryshme tregon se kjo fjalë nuk mund të përkthehet në mënyrë sinonimike në frëngjisht/italisht për shkak se këto gjuhë nuk kanë një barasvlerës të kësaj fjalë që në gjuhën shqipe u referohet si tërësisë së të afërmeve të nuses/dhëndërit kundrejt prindërve e të afërmeve të dhëndërit/nuses, si dhe të afërmeve të miqve të dhëndërit që shkojnë së bashku për të marrë nusen.

Po ashtu, as fjala "krushkapar" nuk është përkthyer, por shpjegohet në tekst me fjalën *chef* (ed. fr. f. 31)/*il capo* (ed. it. f. 23) 'krjetari [i krushqve]'. Për fat të keq, përkthimi del i paplotë sepse është e vërtetë se "krushkapari" është krushku në krye, i pari në radhë, pra ai që u prin krushqve kur shkojnë për të marrë nusen; por, përveç kësaj, fjala nënkupton edhe statusin e

vecante të krushkapatit dhe ritet ceremoniale që vetëm atij i takon t'i kry gjatë festimeve. Pra, megjithëse është dhënë njëfarësoj koncepti theme lexuesit të huaj nuk i shfaqet e plotë figura dhe roli i krushkapatit.

Sa i përket mënyrës se si është shkruar, vërejmë se në botimin frangjisht gjegjësen e vet as në gjuhën franceze as në atë italiane. Për të sillejt shpjegim brenda tekstit si: *ceux que, en raison de la manière dont ils avai été tués ou des circonstances de leur mort, le Kanun déclarait indignes d'être vengés* (ed. fr. f. 161)/*Coloro che per il modo in cui erano stati uccisi o per circostanze della loro morte il Kanun dichiarava indegni di essere vendic* (ed. it. f. 116) 'Ata që, për mënyrën se si ishin vrarë apo për rrethana vdekjes së tyre, Kanuni i shpallte gjakhupes'. Të paktën këtu do t' i dul bërë e qartë lexuesit të huaj se Kanuni parashikon detyrimin për shpajim e gjakut për hir të mbrojtjes së nderit të familjes. Por, në qoftë se gjak njeriut të vdekur nuk është i denjë për t' u larë, për këtë gjak nuk lind fë borxhi shpagues, thënë ndryshe, është gjak i humbur.

4. Fjalë që nuk janë të shpjeguara

Tri fjalë janë lënë në shqip gjatë përkthimit të romanit *Prilli i thy "grosi", "murane"* dhe "raki". Në përkthimin italian, krahas tyre, as fj "lahutë" nuk është përkthyer. Këto fjalë, jo vetëm nuk janë përkthyer, p për to nuk është dhënë ndonjë shpjegim as në tekst, as në fushotë. I interpretimin e tyre, lexuesi mund të mbështetet tek konteksti, edhe f ky i fundit jo gjithnjë është i mjaftueshëm.

Së pari, fjala "grosi" ka të bëjë me veprimin që do të kryejë persona; kryesor i romanit, Gjorg, pas vrasjes: duhet të shkojë në kullën e Oros për të paguar taksen e gjakut. Nga ky kontekst, lexuesi kupton se "grosi është një monedhë (ed. fr. f. 23/ed. it. f. 18). Edhe rastet e tjera në të ci është përdorur, janë kontekste të qarta: kur Gjorgu hyn në një bujtinë f të ngrenë drekë dhe pyet veten nëse është me vend apo jo të shpenzoi monedhat që babai i ka dhënë për të paguar tagrin e gjakut (ed. fr. f. 41/ it. f. 30-31). Në botimin francez, është shkruar sipas shqiptimit në gjuh franceze, *grosches*, kurse në italisht, është shkruar sipas grafisë shqipe *groshe*.

Fjala e dytë është "murane", që në shumicën e rasteve, është lënë shqip, ndërsa në raste të tjera është përkthyer si *marque* (ed. fr. f. 75 *segno* (ed. it. f. 58) 'shenjë', *tumulus* (ed. fr. f. 79)/*tumulo* (ed. it. f. 58) 'reli i formuar nga grumbullimi i dheut apo i rërës', ose si *monticule* (ed. fr

80)/*monticello* (ed. it. f. 58) 'tumbë'. As frëngjishtja as italishtja nuk kanë një sinonim të plotë për këtë koncept. Nga konteksti bëhet e qartë që "murana" është një përmendore kushuar viktimave të gjakmarrjes, por asnjëra nga fjalët e përdorura nga përkthyesit nuk e jep idenë e muranës si "grumbull zuresh".

Në botimin francez, e gjejmë të shkruar sipas rregullave të shqiptimit të kësaj gjuhe, *mourane*, dhe, kur fjala del në numrin shumës, i shtohet si tija përkatesë, ashtu dhe mbaresa –s *les mouranes* (ed. fr. f. 80): kurse në talisht, është shkruar sipas grafisë shqipe dhe vetëm nrya e ben dallimin midis njëjësit dhe shumësit *la/le murana* (ed. it. f. 58).

Fjala e tretë "raki" del gjithsej dy herë. E shkruar sipas grafisë shqipe, si në botimin francez, ashtu dhe në atë italian, konteksti nuk ndihmon të qaptohet nëse "rakia" është apo jo një pije alkoolike:

Nous pouvons vous préparer des oeufs au plat avec du fromage. J'ai aussi du raki. (ed. fr. f. 200)

'Mund të përgatitim vezë të skuqura me dhjathë. Kam edhe raki.'

Possiamo prepararvi uova al tegame con formaggio. Ho anche del raki. (ed. it. f. 144)

'Mund të përgatitim vezë të skuqura me dhjathë. Kam edhe raki.'

Les montagnards ont toujours soigné eux-mêmes leurs plaines et ils continuent de le faire aujourd'hui, avec du raki, du tabac... (ed. fr. f. 215)

'Malësorët gjithmonë i kanë mjekuar vetë plagët e tyre dhe kështu vazhdojnë edhe sot, me raki, duhan...'

Il montanari hanno sempre curato da soli le loro ferite e oggi continuano a farlo, con raki, tabacco... (ed. it. f. 154)

'Malësorët gjithmonë i kanë mjekuar vetë plagët e tyre dhe kështu vazhdojnë edhe sot, me raki, duhan...'

Krahas tri fjalëve të analizuara më sipër, në botimin italian gjejmë dhe fjalën "lahutë". Në botimin francez, shpjegimi për këtë fjalë jepet në ismotë. Në përkthimin italian, fjala lihet pa shpjegim: nuk gjendet ndonjë hënim për të as në tekst, as në fushotë. Për herë të parë del në një kontekst u flitet për baladat që dikur rrefeshin gojarisht apo me lahutë: [...] *ciò he veniva stampato nei libri era solo il cadavere di quello che si narrava ralmente o con l'accampagnamento della lahuta* (f. 121) 'ajo që shrypej ë libra, s'ishite gjë tjetër: veçse kufoma e asaj që rrefehet me gojë apo me thutë'. Këtu, lexuesit nuk i jepet asnjë lloj informacioni: nuk kuptohet nëse ëhet fjalë për një vegël muzikore; për më tepër, nuk jepet ndonjë e dhënë ër formën e veçantë të saj. Akoma më pak ndihmon konteksti në të cilin

shtafet kjo fjalë për herë të dytë: [...] *su alcuni sacchi variopinti, qualcuno aveva appoggiato una lahuta* (f. 144) 'mbi ca trasta ngyra-ngyra, dikush kishte lënë një lahutë'. Vëshitë të kuptosh nga ky kontekst nëse kemi të bëjmë me vegël muzikore apo gjë tjetër. Sa i përket grafisë, përkthyesja i ka qëndruar besnike formës shqipe "lahutë".

5. Përkthimi si përshtatje që mund t'i afrohet/largohet origjinalit

Cështjet e trajtuara më sipër, duhen parë edhe në raport me shkallën e përshtatjes së disa fjalëve dhe fjalive shqipe me ato të gjuhës frënge dhe italiane. Gjuha shqipe, si çdo gjuhë tjetër, përmban fjalë dhe shprehje që pasqyrojnë tipare të posaçme etno-kulturore të popullit. Në tekstet e marrë në analizë, ka shembuj që dëshmojnë se si përkthimi, në disa raste, mund të largohet nga teksti origjinal, kur transferimi nuk ndodh vetëm ndërmjet gjuhës burimore dhe asaj të synuar, por, kryesisht, ndërmjet kulturave respektive. Shpeshherë është e pamundur të përkthehen fjalë ose shprehje kulturore, prandaj kuptimi i fjalës, ose i tërë fjalisë, mund të dalë i mangët, i cënuar.

Rasti i parë që do të marrim në shqyrtim është ai i njësisve frazeologjike "më ka zënë gjaku" (ed. shq. f. 12) dhe "të ka zënë gjaku?" (ed. shq. f. 12), për të cilat nuk mund të bëhet një transferim direkt. Kështu origjinali shqip: "I vinte për të vjellë dhe dy-tri herë tha me vete: më ka zënë gjaku" në frëngjisht, është përkthyer si: *Il avait envie de vomir et il se répéta que ce devait être l'effet du sang* (ed. fr. f. 10) 'I vinte për të vjellë dhe tha përsëri me vete se ky duhej të ishte efekti i gjakut'. Edhe në botimin italian, përkthyesja ka përdorur të njëjtën shprehje: *Avvertiva un senso di nausea e si ripeté che era provocato dall'effetto del sangue* (ed. it. f. 9) 'Ndjente një ndjenjë të vjelluri dhe tha përsëri me vete se ajo ishte shkaktuar nga efekti i gjakut'. Kurse, shprehja të ka zënë gjaku? është përkthyer si në frëngjisht edhe në italisht si *tu n'aurais pas le mal du sang?* (ed. fr. f. 11)/*non avrai il male del sangue?* (ed. it. f. 9) 'mos do të kesh gjak të sëmurë?'. Këto frazeologjizma të gjuhës shqipe, që kanë kuptimin "ndihem fizikisht dhe shpirtërisht keq", në roman shprehin gjendjen e nderë shpirtërore dhe fizike të personazhit kryesor pas kryerjes së vrasjes së rivalit të tij. Në përkthimin francez dhe italian, me këto dy fjali krijohet përshtypja se flitet për një sëmundje të gjakut, dhe jo për dobësinë e shkaktuar nga vetëdija se personazhi ka hyrë në mekanizmin e gjakmarrjes. Ky efekt nuk përcillet as në frëngjisht as në italisht.

Rasti i dytë është ai i fjalës "opingat", që është përkthyer si *soullers* (ed. fr. f. 12)/*scarpe* (ed. i. f. 10) 'këpuçë', pra jepet me një kuptim të përgjithshëm nga i cili nuk bëhet e qartë se "opingat" janë këpuçë të thjeshta, me formë të veçantë sepse të mblehdhura anës e të lidhura me retina, që përdroreshin kryesisht nga fshatarët.

Edhe disa terma që i referohen botës së marrëdhënieve familjare nuk gjëjnë një barasvlerës të plotë në gjuhën franceze dhe italiane. Në këtë roman, për shembull, paraqiten format: "vëllazëri", "farefisi" dhe "fis". Sipas fjalorit të gjuhës shqipe (1980), "vëllazëria" është 'tërësia e vëllëzërve, e njerëzve të një gjaku'; domethënë një rreth që përfshin jo vetëm vëllëzër e motra por edhe kushërinj të afërt. "Farefisnia" është 'tërësia e njerëzve që kanë lidhje gjaku ose gjinie ndërmjet tyre'. "Fisi" është grup njerëzish me lidhje të afërta gjaku, që rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët. Në gjuhën shqipe, me sa duket, shtrësa leksikore lidhur me emrat e farefisnisë del më e pasur sesa në frëngjisht dhe në italisht. Në frëngjisht dhe në italisht, nuk mund të saktësohet mirë kuptimi i këtyre fjalëve, siç dëshmohet nga mënyra se si vijin të përkthyerat: "vëllazëri" është përkthyer, herën e parë, si *nos proche* (ed. fr. f. 13)/*i parenti* (ed. it. f. 11) 'të afërmit', dhe pastaj si *conférie* (ed. fr. f. 32)/*confaternita* (ed. it. f. 24) 'shoqatë'.

"Farefisi" është përkthyer si *parents proches et lointains* (ed. fr. f. 15)/*parenti stretti e lontani* (ed. it. f. 12) 'farefis i afërm dhe i largët'.

"Fis" është përkthyer, herën e parë, si *parents* (ed. fr. f. 16)/*i parenti* (ed. it. f. 13) 'të afërmit', dhe pastaj si *clan* (ed. fr. f. 32)/*clan* (ed. it. f. 24) 'fis'.

Pra, nëse fjalët "vëllazëri", "farefisi" dhe "fis", në gjuhën shqipe, kanë vlera të veçanta kuptimore, në përkthimin frëngjisht dhe italisht ky dallim nuk bëhet i qartë. Këtë e dëshmon fakti se për të tria përdoret e njëjta fjalë *proches/parents* (fr.)/*parenti* (it.) 'të afërmit', por kjo fjalë, që është më e përafërta në gjuhën franceze dhe italiane, nuk e rrok të gjithë përmbajtjen e koncepteve që duhet të shënojë.

Një koncept tjetër po aq i vështirë për t'u sjellë si në gjuhën frënge, ashtu dhe në atë italiane është dallimi midis "vajtores" dhe "gjëmëtarit". "Vajtores", sipas fjalorit, është 'gruaja që merrret me pagesë për të vajtuar e për t'u ulur te koka e të vdekurit', kurse "gjëmëtarit" është 'burri që i bie me grushta gjoksit dhe me thoni gërvishit fryrën'. E para rrjedh nga fjala "vaj": në vaj, njeriu vetëm derdh lot; e dyta rrjedh nga fjala "gjëmë": në gjëmë, njeriu kryesisht bërtet fort si gjëmin qielli, por pa derdhur lot sepse burrat mund të ulëraasin, por nuk qajnë. Gjuha frënge ka fjalën *pleureur/pleureuse* 'burri/grua që qan', por pa asnjë dallim midis dy figurave. Gjuha italiane nuk bën dallim midis burrit dhe gruas, ka vetëm fjalën *prefica*, për të cilën fjalori jep këtë përcaktim: *Nell'antica Roma, donna pagata per far parte di cortei funebri e intonare canti di elogio del defunto, accompagnati da grida di dolore, piante, gesti di disperazione* 'Në Romën e lashtë, gruaja e paguar për të marrë pjesë në varganin e varrimit dhe për të kënduar këngët e lavdërimit të të ndjerit, të shoqëruar nga kllithmat e dhimbjes, vajet, glesat e dëshpërimit'.

Në Shqipëri, dallimi midis "gjëmëtarit" dhe "vajtores" lidhet me një zakon dhe procedurë etnografike që parashikon si të thuash, veprime të

koduara dhe krejt të ndryshme mes burrit/gjëmëtarit dhe gruas/vajtores gjatë rritit mortor. Gjama, e kryer nga burrat për të vdekurin, është traditë mortore tipike e Shqipërisë së Veriut, e lidhur me doke e zakone të lashta që vijin nga Kanuni, ku dëshmohet se:

"Tuj ba gjamë burrimini, grrishten edhe tundin krahnorin" (Libri XII, krye XXIV, neni 1235)

"Miq, qi grrishten fytre në dekë të mikut nuk do t'i lajn faqet e pergjakuna as në shpi, as në katund të të deknutit e as per udhë, por si të mbrrijnë shpi të vet" (Libri XII, krye XXIV, neni 1251)

Kështu përskruhet nga Kadareja tradita në romanin *Prilli i thyer*, ku autori u referohet "gjëmëtarëve", që e qajnë të vdekurin sipas rritit të Malësisë:

"Gjëmëtarët erdhën nga larg, duke grrisur fytyrat e duke shkullur flokët sipas dokeve" (ed. shq. f. 16).

"Gjëmëtarët i kishin ende fytyrat të çjerra e të gjakosura. Zakoni e kërkonte që ata të mos i lanin fytyrat as në katundin ku kishte ndodhur vdekja e as udhës. Mund ta bënin këtë vetëm kur të mbërrinin në fshatrat e tyre" (ed. shq. f. 18).

Është ky një zakon me traditë të lashtë që është trashëguar brez pas brezi nga stërgjyshërit dhe është dëshmi e kulturës së popullit, që shpreh mënyrën se si e kupton ai botën që e rrethon. Fatkeqësisht, lexuesit e huaj nuk i transmetohet asgjë në lidhje me këtë traditë të lashtë të popullit shqiptar.

6. Përfundime

Në fund të këtij punimi mund të themi se vështirësitë më të mëdha që dalin gjatë përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën frënge dhe italiane (por që në të vërtetë dalin gjatë punës së përkthimit në përgjithësi) lidhen jo vetëm me mospërpunshëm e fjalëve shqipe me ato të gjuhës së synuar, por sidomos lidhen me përkthimin e shprehjeve që i përkasin diversitetit kulturor, historisë dhe kulturës së popullit, dokeve e zakoneve të vendit. Çdo përkthim pasqyron lidhjen e gjuhës me kulturën, sepse gjuha është shprehje e kulturës; prandaj përkthyesi duhet të jetë jo vetëm bilingual por edhe bicultural, sepse ai duhet të përkthejë e t'u përcjtojë mesazhe pikë së pari anëtarëve që i përkasin një grupi të huaj sa gjuhësor po aq dhe kulturor.

Romani *Prilli i thyer* mbart në vetvete kumte e shprehje që u referohen dukurive që mund të kuptohen plotësisht vetëm në kontekstin kulturor ku kanë zanafillën burimore dhe plotësinë e tyre. Këto, shpeshherë, vijnë të mangëta e të gjymtuara në përkthim. Megjithatë, pavarësisht shkallës së lartë të ndërlikimit të këtyre problemeve gjatë procesit të përkthimit, jidhur me kufizimet e diktuara nga një kontekst i ri gjuhësor dhe kulturor, kjo nuk i ka penguar përkthyesit të na sjellin një tekst nga më të mrekullueshmit e letërsisë shqipe të sotme: një tekst që ngjall tek marrësi i një kulture të ndryshme nga ajo shqiptare të njëjtën përgjigje emocionale që ngjall tek lexuesi original, duke dëshmuar se përkthimi i një vepre na lejon gjithmonë të kapërcejmë barrierat gjuhësore dhe na mundëson komunikimin midis kulturave sado që ngre probleme me rëndësi teorike dhe praktike.

BIBLIOGRAFI

- AA.VV. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1980.
- Gjegovi, Sh. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuveni, 2001.
- Kadare, I. *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë, 2003.
- Kadare, I. *Aprile spezzato*, Longanesi, Milano, 2008.
- Kadare, I. *Avril brisé*, Fayard, Paris, 1982.

EMINE SADIKU

**Konsumimi semantik
burim i pashtershëm shprehës**
(ilustruar me material gjuhësor
nga proza e I. Kadarës)

Semantic consumption as an unfathomed source of expressivity

Abstract: *The stylistic effects of semantic consumption in any literary text have to do with the growth of the creative and affective potency of the speech through the usage of more expressive lexical units rather than their synonyms, which are erased by the expressive effect. The mechanism of this phenomenon is implemented within a given text whenever the information provided is not only operative but also impressive. Semantic consumption implemented is not or more language elements. The element, which is considered semantically consumed, may appear along the discourse and it can be supplemented by a more expressive synonym reinforcement or, it may not appear at all in the text. They deviate depending on the literary-artistic awareness of the author. In their place emerge synonymous units which enjoy remarkable content and expression. Writer Ismail Kadare, for instance, is an expert in extracting the right term from the core of the language to further elaborate it.*

Keywords: *Phonetic linguistic consumption, contextual synonyms, symbolic sign, iconic sign, expression.*

Në ligjërim, sidomos në ligjërimin afektiv, shpesh lihen mënjana fjalët e harxhuara kapëtimisht, të konsumuara.

Konsumimi i fjalëve mund të ndodhë për shkakë fonetike ose për shkakë semantike.

Në shumë raste fjalëve shumë të shkurtra, u mungon shprehësia, atë biletë mund të zhdruken krejt. Psh. Në asnjë gjuhë romane nuk mbijeton fjala e shkurtër latine *os* (gojë). Vetë latinishtja vulgare, për të ruajtur një numër fjalësh, i zgjaste ato me prapashtesa si *apis, auris, sol*. Me anë të tyre janë formuar fjalë, si *apicala, auriculus*, ..., *soliculus* (bletë, vesh, diell). Në këtë raste prapashtesat nuk kanë vlerë diminutive, por përdoren për të rritu volumin e fjalës. Një dukuri e tillë vihet re dhe në gjuhën shqipe. Psh.: Fjalë *vëzë* është e zgjeruar fonetiksht. Prapashtesa *-zë* nuk është afiks me vlerë diminutive, por përdoret për zgjerimin e vëllimit fonetik të fjalës *vë*.

Kur dy fjalë bëhen homonime (dmth përputhen fonetiksht) për shka